

ARRIJNË DOKUMENTE NGA ARKIVAT TURKE PËR

MEHMET PASHË DERALLËN

Ramë MANAJ

Të nderuar pjesëmarrës në këtë Konferencë, duke shprehur mirënjohjen time për ftesen për pjesëmarrje, fillimisht në emër të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës dua të falënderoj ideatorët dhe vetë organizatorët e kësaj konference, e cila, padyshim, siç edhe pritet, do të japë një kontribut të çmueshëm për ndriçimin e njërës prej figurave madhore të historisë së popullit tonë, Mehmet Pashë Derallën.

Përderisa çdo popull ka historinë e tij, historia e popullit tonë është histori e një populli të vjetër dhe stoik ndaj shumë e shumë sfidave e përballjeve në shumë luftëra për lirinë e tij, është një histori e bujshme. Të tillë e bëjnë ngjarjet dhe figurat e mëdha përgjatë shekujve e mileniumeve. Mirëpo, historianët kanë ende punë të madhe para vetes: ka ende shumë ngjarje dhe figura, tek të cilat ende nuk kanë depërtuar rreze të mjaftueshme drite. Përndryshe, sa më shumë hidhet dritë mbi të kaluarën, historia jonë del të jetë më e begtashme dhe më e bujshme.

Fillimet e shekullit 20 shënojnë muzgun e Perandorisë osmane, e cila afër 5 shekuj shkeli trojet tona, në njëren anë, por edhe lindjen e shtetit të ri shqiptar, nga ana tjetër, sadoqë në më pak se gjysmën e tokave shqiptare /Shqipëria londineze/. Në harkun kohor të këtyre dy ngjarjeve dhe në orbitën e zhvillimeve të këtyre kohëve është një personalitet, i cili me kontributin e tij, la gjurmë të pashlyeshme në kohë. Megjithatë, kjo figurë dhe ky kontribut sikur ka mbetur në pamjaftueshmëri njohjeje. Prandaj, aq sa është e rëndësishme të eliminohen të panjohurat e të së kaluarës e të ndriçohet historia në plotninë e saj, mendoj unë, pokaq meritojnë mirënjohje organizatorët e kësaj Konference dhe synimeve të saj patriotike e shkencore-historike.

Ne në Arkivat e Kosovës po përpiqemi në vazhdimësi që të vjelim dokumente e burime të reja, deri tani të panjohura për ngjarje, zhillime dhe personazhe të historisë sonë, t'i ruajmë e mbrojmë ato, pra që sa më shumë të eksplorojmë burime dokumentare të historisë.

Këtyre ditëve, duke hulumtuar në Arkivat turke që ruajnë burime të pashterrshme edhe për të kaluarën tonë, kemi evidentuar disa shkrime për Mehmet Pashë Derallën /Mehmet Ruzhdi Pashën/, të cilit me sens të plotë i kushtohet kjo ngjarje kulturore-shkencore, ndër të cilat:

Emërimi i Mehmet Ruzhdi Pashës guvernator (vali) i Sirisë;

Emërimi i Seraskerit (ushtarit) të mëparshëm Mehmet Ruzhdi Pasha në Udhëheqësinë e Ushtrisë së veçantë;

Emërimi i Mehmet Ruzhdi Pashës udhëheqës i Depove të armëve;

Telegraf nga Vilajeti i Danubit (Tunës) për Emërimin e Mehmet Ruzhdi Pashës në Rezidencën Kryeministore (Sadaret);

Kërkesa për largimin e Komandantit të Xhandarmërisë së Manastirit, Mehmet Ruzhdi Pasha;

Ndërrimi i Mehmet Ruzhdi Pashës Komandant i Xhandarmërisë me Hasan Beun, i graduar i shkallës IV dhe V në Manastir;

Ferman i dërguar për Valiun e Silistrës, Mehmet Ruzhdi Pashën dhe Gjykatësin e Ballxhikut për shpenzimet rreth vendosjes së çadrave (tendave) për çetat e seraskerëve dhe oficerëve të Gardës së shenjtë (Liva-i Sherif), shpenzime që i ishin ngarkuar Kazasë së Ballxhikut nga Fondi i tubuar nga fshatrat Kavama dhe Sogytçyk;

Dispozita e Valiut të Silistrës, Mehmet Ruzhdi Pasha, për modifikim dhe ndryshim të disa të dhënave që kishin të bënin me Kalanë e Silistrës;

Dhënia e Gradës I të Nishanit osman, ushtarit Mehmet Ruzhdi Pasha nga Sekretari kryesor i Ndërmjetësuesit të Sulltanit - Ismail Haki Beu;

Përcaktimi i pagës për seraskerin (ushtarin) Mehmet Ruzhdi Pasha;

Falënderimi i Mehmet Ruzhdi Pashës për përcaktimin e pagës së tij;

Kënaqësia e Padishahut nga falënderimi i Mehmet Ruzhdi Pashës për dhënien e pagës;

Dekorimi i Mehmet Ruzhdi Pashës –Kryetar i Komisionit të lartë;

Dhënia e një sasive të përcaktuar të pagës së Mehmet Ruzhdi Pashës, Udhëheqës i Deposë së armëve në Fondin e kësaj depoje etj.

/Renditja është bërë nga unë dhe nuk përputhet me renditjen në Arkivat turke/.

Këto shkrime pritet të arrijnë dhe të futen në fazën e deskriptimit dhe përkthimit. Pas përfundimit të këtij procesi nga ekspertët, ato do të publikohen dhe do të mund të shfrytëzohen nga hulumtues për qëllime shkencore e publicistike.

Pa e zgjatur më tej, unë uroj sukses të plotë punimeve të kësaj Konference.